



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1113/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj, dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Bardhyl Sylejmanit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Viti, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 27.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Bardhyl Sylejmanit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Viti, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 24.11.2017, ka pranuar një apel nga Bardhyl Sylejmani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Viti, me të cilën ka theksuar se pasi KQZ ka publikuar rezultatet me datë 08.11.2017, ka fituar mandatin për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti me 163 vota, ndërsa më datë 23.11.2017 është diskualifikuar nga lista, ku pas rinumërimit të disa kutive i mungojnë 9 vota. Në mbështetje të pretendimeve, apliti i ka bashkangjitur Raportin e KQZ, Rezultatet Përfundimtare nga QNR-ja.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë së apelit, gjeti se:

apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Bardhyl Sylejmani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Viti është i palejuar. Sepse KQZ ka shpallur Raportin e kandidatëve që kanë fituar

mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, ku nga ky rinumërim ka dal fitues Vehbi Rama, nga radhët e subjektit politik AAK për Komunën e Vitisë me 157 vota, ndërsa ka humbur mandatin parashtresës i ankesës Bardhyl Sylejmani kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Viti, nga radhët e subjektit politik AAK me 154 vota.

Me dispozitën nenin 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Rezultatet Zgjedhore) i cili përcakton se: “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Parashtresat dhe Ankesat”. Për më tepër nuk e përcakton asnjë dispozitë ligjore të parashtrohet ankesë ndaj rezultatit që rezulton pas rinumërimit me vendimin e PZAP-it.

Prandaj, nga këto arsye arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1113/2017 me datën 27.11.2017



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa